



BASHKIA  
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK

**V E N D I M**

**Nr. 37 , datë 7.04.2020**

**“PËR**

**TRAJTIMIN E PËRKOHSHËM FINANCIAR TË DISA FUNKSIONARËVE DHE  
NËPUNËSVE TË BASHKISË TIRANË GJATË KOHËZGJATJES SË PERIUdhËS SË  
INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1 shkronja “b”, nenit 54, shkronja “ç”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, nenit 2, shkronja “c” dhe nenit 5, të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, nenit 135, pika 2, shkronja “d”, nenit 160 dhe nenit 167, pika 5, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, Vendimit nr. 243, datë 24.3.2020 të Këshillit të Ministrave “Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, Vendimit nr.157, datë 27.12.2019, të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2020-2022 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2020”, të ndryshuar, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I:**

1. Kryetari i Bashkisë Tiranë nga data 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID 19, por jo më shumë se tre muaj, përfiton pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.
2. Nënkryetarët e Bashkisë Tiranë për muajin prill 2020, përfitojnë pagë mujore neto në masën 50% të pagës mujore neto aktuale.
3. Nëpunësit/punonjësit e Bashkisë Tiranë që janë anëtarë në borde dhe këshilla mbikëqyrës/administrimi të shoqërive aksionare me kapital mbi 50 % në pronësi të Bashkisë Tiranë, për periudhën nga data 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, por jo më shumë se tre muaj nuk e përfitojnë shpërblimin përkatës.
4. Strukturat përkatëse financiare të derdhin shumën e papaguar në buxhetin e shtetit, në llogarinë antiCOVID-19 të hapur pranë bankës së nivelit të dytë, Credins Bank, me numër llogarie në lekë nr.1348338, me IBAN: AL 152121 1016 0000 0000 0134 8338.
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar sipas pikës 1 dhe administratorët e shoqërive aksionare sipas pikës 2, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**KRYETAR**  
  
**TONI GOGU**